

VENDIM
Nr. 76, datë 6.11.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME HIMARË**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.11.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

konstatoi se:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Himarë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 2, datë 19.1.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Himarë ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 80 prot., datë 5.7.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për tarifën mujore, shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Himarë kishte mangësi në dokumentin “Mendimi i pronarit (Njësia e Qeverisjes Vendore) për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori”.

ERRU-ja iu drejtua shoqërisë, me shkresën nr. 350/1 prot., datë 20.7.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Himarë, me shkresën nr. 96 prot., datë 11.10.2018 ka dërguar dokumentin e munguar “Mendimi i pronarit (Njësia e Qeverisjes Vendore) për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Himarë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë dhe Bashkinë Himarë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani